



Policia e Shtetit

Lajmet e Fundit:



04/05/2020

Kurbin – Ndërhyrja në kohë e Policisë parandaloi një ngjarje të mundshme kriminale në familje

Ushtronte dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes dhe dispononte armë zjarri pa leje, u largua nga banesa sapo pa shërbimet e Policisë, por pas kontrolleve dhe rrethimit të zonës vetëdorëzohet 47-vjeçari.

Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë, me krehër me 5 fishekë.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimit në Komisariatit e Policisë Kurbin arrestuan në flagrancë shtetasin A. P., 47 vjeç, banues në Kurbin.

Policia e Kurbinut, pas marrjes së njoftimit se ky shtetas ushtronte dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes në banesë, ka ndërhyrë menjëherë duke parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës.

Shtetasi A. P., kur ka konstatuar shërbimet e Policisë, është larguar menjëherë nga banesa, por pas kontrolleve të shumta dhe rrethimit të zonës, pas disa orësh u vetëdorëzua te shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, Policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri pistoletë, me një krehër me fishekë.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në ngarkim të shtetasit A. P., për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Armëmbajtje pa leje”.

Share

 Share

 Share

[in](#) Share

 Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



GET IT ON

Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linge

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Strukturat e Policisë së Shtetit kanë vijuar kontrollet në të gjithë vendin, për monitorimin e zbatimit të masave kufizuese, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Përrjashtohet nga Policia e Shtetit, për shkelje të rëndë të Kodit të Etikës dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, punonjësi i Policisë që u shfaq në videon e publikuar në rrjetet sociale ►